



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr.68. datë 24.12.2007

**Për miratimin e Udhëzuesit
“Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PËRPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtar
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt:

Miratimi i Udhëzuesit “Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”.

Baza ligjore:

Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa d, si dhe nenet 69 e 70.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VËREN SE:

Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 69 vendos detyrimin ligjor për organet e administratës qendrore dhe vendore të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me:

- a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
- b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
- c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Gjithashtu në bazë të nenit 70 të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e

veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

Ndërsa Autoriteti i Konkurrencës për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi i projekt-akteve ligjore për pasojat mbi konkurrencën është një kusht i domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, si dhe nenet 69 e 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit "Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën", sipas formës bashkëlidhur këtij vendimi së bashku me anekset përkatëse.
2. Ky udhëzues është i detyrueshëm për Autoritetin e Konkurrencës.
3. Ky udhëzues rekomandohet të zbatohet nga organet e administratës qendrore dhe vendore, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në nenin 69 të Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".
4. Ngarkohet Sekretariati për dërgimin e këtij Udhëzuesi, pranë organeve të administratës qendrore dhe vendore, enteve dhe institucioneve të tjera rregullatorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

U shpall në Tiranë, sot më 24.12.2007

ANËTARËT

Lush PËRPALI

(_____)

Zv/Kryetar

Servete GRUDA

(_____)

Anëtare

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

KRYETARE